



GJL. nr.1299/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVJATJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehuri Dilaver Kryeziu, nga Prishtina, përmes avokatit-Nikë Shala, Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.18223/2012, të dt. 17.10.2012, e në bazë të neneve 31 al. 3, 39 dhe 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datë 19.11.2012, nxjerr:

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i atakuar, ashtu që ndaj të pandehurit Dilaver Kryeziu, nga Prishtina, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse si në vështrim të nenit 198.2 e lidhur me nenin 11 të Ligjit për Kundërvajtjet, ngase i pandehuri e ka përmbushur obligimin e përcaktuar para se të merret aktvendimi për kundërvajtje, gjegjësisht para se ndaj tij të filloj procedura kundërvajtëse.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Regj.I.nr.18223/2012 të dt. 17.10.2012, të pandehurin Dilaver Kryeziu nga Prishtina, e ka shpallë përgjegjës, sepse si zyrtar i lartë publik- drejtor i Ansambllit Kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota", në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë e cila bëhet me deklarin e rregullt vjetor deri me datë 31.03.2012, të çdo viti kalendarik në Agjensionin Kundër Korrupsionit (AKK), me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 par. 1 dhe 2 si dhe neni 9 të Ligjit nr. 04/L-050, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 1000€ (njëmijë).

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 €.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur i pandehuri Dilaver Kryeziu, përmes avokatit Nikë Shala, për shkak të vendimit mbi dënim dhe më tutje pasi e përshkruan dispozitivin e aktvendimit të shkallës së parë në arsyetim ndër të tjera thekson; se dënimi i shqiptuar me gjobë në shumë prej 1.000 € është shumë i lartë duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese të cilat qëndrojnë në anën e të pandehurit, siç janë se i pandehuri e ka pranuar kundërvajtjen, se në kohën për paraqitjen e deklarin të pasurisë ka qenë në R. të Shqipërisë në mbajtje të koncerteve, se i njëjti nuk i ka dëshiruar pasojat e kësaj vepre kundërvajtëse, andaj nga të lartcekurat propozon që aktvendimi i goditur të ndryshohet sa i përket lartësisë së dënimit dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim nën minimumin e paraparë Ligjor.

03-4654/12/02
sig.

2.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, kërkesën e AKK-së për fillimin e procedurës kundërvajtëse aktvendimin e goditur, deklaratën e të pandehurit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë me datë 23.08.2012, si dhe shkresat e tjera të lëndës, e duke shqyrtuar lëndën edhe sipas detyrës zyrtare me rastin e ankesës si në vështrim të nenit 219 të Ligjit për Kundërvajtjet, konstaton se ankesa e paraqitur është e bazuar, kurse aktvendimin e goditur e ndryshoi ashtu që ndaj të pandehurit Dilaver Kryeziu, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform nenit 198 al.1 pika 2 të Ligjit për Kundërvajtjet, sepse në rastin konkret ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse e të pandehurit.

Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të shkresave të lëndës dhe deklaratës së të pandehurit i cili e ka pranuar kryerjen e kundërvajtës se deklarimin e pasurisë nuk e ka bërë gjerë me 31 Mars 2012, e duke e marrë si justifikim udhëtimin e tij jashtë vendit, mirëpo i njëjti deklarimin e pasurisë e ka bërë më datë 12.04.2012, (dëshmi vërtetimi i AKK nr. 03/3422/12 i dt. 12.04.2012), ndërsa AKK me datë 21.05.2012, ka parashtruar kërkesë ndaj të pandehurit për fillimin e procedurës kundërvajtëse për mos deklarim të pasurisë. Gjykata e shkallës së parë pas zhvillimit të procedurës kundërvajtëse të pandehurin e shpallë përgjegjës për mos deklarim të pasurisë gjerë më 31. Mars 2012, dhe të njëjtin e dënnon me gjobë në shumë prej 1.000€.

Kolegji konstaton se në rastin konkret ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë e të pandehurit për arsye se i njëjti e ka përmbushur obligimin e deklarimit të rregullt të pasurisë më datë 12.04.2012, dhe me këtë veprim të tij janë evituar pasojat e veprës kundërvajtëse para se të parashtrohet kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e AKK-së ndaj tij më datë 21.05.2012 dhe në rastin konkret ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje ashtu siç parashihet me nenin 11 al.1 të Ligjit për Kundërvajtje, ku sipas këtij neni ndaj kryerësit të kundërvajtjes mund të pezullohet procedura kundërvajtëse nëse kryerësi i kundërvajtjes para se të merret aktvendimi e ka përmbushur obligimin e përcaktuar ose e ka kompensuar respektivisht e ka evituar dëmin e shkaktuar, në këtë rast Kolegji konsideron duke pas parasysh natyrën e kundërvajtjes dhe vetit personale të kryerësit dhe rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja mund të pritet se kryerësi edhe pa dhënien e dënimit në të ardhmen nuk do të kryej kundërvajtje. Sipas nenit 11 al.2 në këto raste apo të ngjashme Gjykata kur e fillon procedurën kundërvajtëse mund ta paralajmëroi të pandehurin që brenda një afati të caktuar ta përmbush obligimin e përcaktuar dhe nëse kundërvajtësi e bënë një gjë të tillë më së largu në afat prej 30 ditë ndaj tij do të pezullohet procedura kundërvajtëse.

Nga të lartcekurat konform nenit 221 të Ligjit për Kundërvajtjet u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa
GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË SHQIPTINË
GJL. nr.1299/2012, të dt.19.11.2012.

SEK. JURIDIKE,
Ganimete Dumani

